

Pseudoatdhetarët dhe vapa zgjedhore

Nga Elona BANO

M'u desh të vëzhgoja gjithë javën para- dhe paszgjedhore me apo pa dashje rrjetet sociale për t'u velur nga ata njerëz që me apo pa shkak duan patjetër ta quajnë veten "atdhetarë". Ata që s'lanë kronikë televizive apo deklarata politikanësh pa e komentuar vetëm me dy ngjyra: ose shumë bardhë, ose zi sterrë. Ata që të parët vënë kujën e bërtasin me "oi", nëse asgjë s'ndodh apo nëse shumë gjë ndodh. Ata që, edhe pse kanë mbaruar studimet apo kanë zgjedhur të punojnë jashtë vendit, sërish na dërgojnë ultimatumet apo "këshilla" rreth asaj çfarë duhet të bëjmë apo të mos bëjmë ne "të paudhët" e "të pagdhendurit", që sipas tyre jetojmë në atdhe.

Ata që u qan e "u dhemb shpirti" për atdheun e meken në lot e staturë në rrjetet sociale sa herë kemi zgjedhje parlamentare, lokale apo ngjarje të veçanta me rëndësi për shtetin e së drejtës. Ata që me "penën moderne" të tastaturës së kompjuterit apo celularit nuk lënë figurë tronditëse, dëshpëruese, përletëse pa vendosur për çdo ngjarje të mirë apo më pak të mirë, siç e quajnë rëndom ata, por që po shkatërrojnë mëmëdheun. Ata që harrojnë se edhe pjesa më e madhe e elitës shqiptare aktuale e ka kaluar dhe përjetuar periudhën e "mërgimit" me studime apo punë jashtë vendit dhe e ka të vështirë rikthimin, por që stoikisht nuk demoralizohet, përkundrazi, vazhdon të sjellë frymë të re, ekuilibër, tolerancë e vlera për shoqërinë shqiptare, dhe jo me ultimatumet nga jashtë vendit, por me punë, përpjekje, durim e mençuri brenda fort të dashurit atdhe. Kuptoni ju pseudoatdhetarë se Shqipëria më shumë u dhimbset atyre që jetojnë e kontribuojnë për të, atyre që ashtu si ju, edhe pse morën vlera në vende të ndryshme të botës, morën vendimin më të duhur dhe të mençur: kthimin në vendin e tyre dhe kontribuimin e singertë e të pakushtëzuar për të.

E që të kthehem nga u nisëm, sikur të mos na mjaftonin deklaratat acide apo të sheqerosura, sipas rastit, të partive e militantëve nëpër rrjetet sociale e në çdo medie të shkruar apo vizuale, sikur të mos na dilnin fletushkat nën apo mbi derë të partive si ofertat e qendrave tregtare, na duhet të "përndiqemi" edhe *on-line*. Kur them *on-line*, nuk i referohem uebeve të ndryshme, por pikërisht "Facebook"-ut dhe "Twitter"-it, ku miqtë e mi të parët (jam e bindur dhe shumë miq trajtë), si Sami Frashëri apo Abdyli në vakt i bëjnë thirrje për kryengritje mëmëdheut. Falmë, o Zot, këtë krahasim, pasi ata në shekullin XIX ishin e vetmja dritë dhe frymëmarrje për kombin shqiptar të nënshtruar ndaj fatit të atëhershëm.

Po si fillon kjo histeri fesbukiane? Cilat ishin statet që ajo kaloi? Në fillim e morën me të qetë dhe shtruar bërjen e *like* sa majtas e djathtas, duke harruar se kështu pak e nga pak e lanë veten të manipuluar e, për rrjedhojë, dhe sjellja e tyre e mëvonshme do të varej nga çka ata do t'i lejonin vetes të shihnin e të dëgjonin. E kështu njerëzit e kthyen vullnetin e tyre në një plastelinë të modelueshme sipas vullnetit të dikujt tjetër.

Pra, a është normale e gjithë kjo çmenduri kolektive? Të mos keqkuptohemi: nuk jam kundër lirisë së shprehjes, dhe as kundër së drejtës për të shprehur lirshëm bindjet politike, vetëm se nuk më duket normale që vetëm të çirremi me të madhe si e si për të tërhequr vëmendjen e njerëzve, pasi, kur njeriu (të paktën sipas mendimit tim modest) është i trishtë, i pashpresë apo i merakosur, gjënë e fundit që mendon është si të bjerë në sy. Dilema ime e vërtetë është: sa u intereson vërtet fati i mëmëdheut këtyre atdhetarëve në mërgim dhe sa për ta kjo është mënyra më e mirë për të rënë në sy? Sa në këtë mënyrë kërkojnë të tërheqin vëmendjen e të tjerëve për të zënë një vend platonik edhe në shoqërinë shqiptare?

Po a e meritojnë këta atdhetarucë të kenë vëmendjen e vetë shoqërisë shqiptare? A janë ata aq të pjekur sa të vijin me analiza konkrete mbi dhe ndaj realitetit shqiptar, ku së paku të bazojnë mendimet, opinionet dhe "këshillat" e tyre të pakursyera? Besoj se shumë pak ose aspak. Për disa arsye të thjeshta. Në radhë të parë duhet bërë një ndarje kategorish: ata që kanë kontribuar dhe kanë dhënë për Shqipërinë e në një moshë të pjekur janë larguar prej këtu e që vërtet mund të kenë diçka për të thënë, por edhe këta të kufizuar, për shkak se nuk mund ta njohin aq mirë realitetin e vendit pritës sa të mund të bëjnë krahasime; nga ana tjetër është rinia, që ka ikur që herët prej Shqipërisë dhe njeh vetëm dy fytyra të saj: fytyrën e Shqipërisë që ata lanë dhe fytyrën e Shqipërisë që në të vërtetë është. Kur mora përsipër të shkruaja këtë shkrim, nuk u nisa nga abisi, nga hiçi apo mosnjohja e situatës, apo të paktën e ndjesive që përjeton një njeri që jeton jashtë për një kohë të gjatë, i cili, edhe pse është ambientuar me jetën jashtë Shqipërisë, sërish thellë vetes ndihet i huaj dhe kërkon në një mënyrë apo tjetër të bëhet pjesë e realitetit shqiptar. Por, të dashur miq, që jeni larg, nëse doni t'i vini vërtet në ndihmë vendit, atëherë filloni të lexoni më shumë rreth ngjarjeve që ndodhin ditë pas dite, mundohuni të lexoni përmes rreshtave të deklaratave politike apo shkrimeve gazetareske. Juve me shumë se atyre që jetojnë dhe e ndiejnë përditë realitetin ju duhet kjo, e në fund, pasi të jeni menduar 100 herë, filloni të shpreheni. Kuptoni dhe ndërgjegjësohuni se fryma e solidaritetit që ju keni me njëri-tjetrin do të jetë shumë herë më e dobishme, nëse vini me plane konkrete dhe optimiste për t'u realizuar brenda vendit e në dobi të tij, se sa duke vazhduar simfoninë e lotëve pa fund.

Për t'ju qetësuar ju siguroj se më në fund tranzicioni u kalua, u la pas, jo më shumë ai ekonomik sesa ai psikik. Arritëm të kuptojmë edhe ne se progresi mund të vijë vetëm në mënyrë paqësore, me durim, me votë dhe me qytetari. Të rinjtë votues po ashtu i dhanë një shuplakë së vjetrës, duke marrë pjesë gjerësisht në votime, duke u dhënë elitave politike të kuptojnë se epoka e turmës mbaroi, se ka ardhur era e reagimit dhe e ndërgjegjësimit të lirë e jo të imponuar, pra epoka e vetvetes dhe individualitetit konstruktiv.

E si zgjidhje në mbyllje të këtij shkrimi më erdhi në mendje një shprehje e të famshmit Benjamin Branklin, që ka thënë: "Mendjemadhësia dhe krijimi i problemeve të paqena na rëndojnë më shumë se qeveritë dhe parlamentet. Të shërohem nga këto, në mënyrë që të mund të durojmë dhe të kuptojmë më mirë qeveritë dhe parlamentet."